



Qendra e Studimeve  
Parlamentare

# BULETIN

www.ascpdp.org



Ambasada Britanike  
Tiranë

## Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.2

maj 2006

### Intervistë me Enno BOZDO

Zëvendësministër i Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjitikës

1. Marrëveshja e Përkohëshme (Neni 19 i MSA) përcakton se detyrimi i importit për një sërë produktesh industriale reduktohet në 80% të detyrimit bazë në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, ndërkohë që më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi detyrimi i importit reduktohet në 60% të detyrimit bazë. Cilat janë politikat që po ndjek qeveria për zbutjen e efekteve në buxhetin e shtetit dhe me pas në gjenerimin e investimeve publike?

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, ka si pjesë përbërëse të saj marrëveshjen e ndërmjetme për tregtinë e lirë, pra ka pjesë të saj marrëveshjen pothuajse klasike për tregtinë e lirë. Klasike në kuptimin e parimeve dhe normave tregtare ndërkombëtare, por specifike në kuptimin e produkteve të negociuara dhe mënyrave të liberalizimit të tyre. Pyetja e mësipërme i referohet vetëm produkteve industriale, por marrëveshja përfshin edhe liberalizimin e produkteve bujqësore në tregtinë ndërmjet dy vendeve.

(vijon në faqen 2)

### Politika tarifore apo reforma standarde: Vlefshmëria e argumenteve

Engjëll Skreli, Dr.

Instituti Shqiptar për Politikën Publike

Dy vitet e fundit ka patur një debat të ashpër mes biznesit dhe qeverisë lidhur me mbrojtjen e prodhimit vendas. Shoqatat e biznesit kërkojnë me këmbëngulje mbrojtjen e prodhimit vendas me tarifa doganore. Vitin kaluar, biznesi ja doli me sukses të rrisë tarifën doganore të birrës nga 15% në 20%, ndërsa aktualisht biznesi po ushtron trysni për të rinegociuar rritjen e tarifave doganore të konformuara me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të OBT-së. Argumenti i biznesit, i amplifikuar nga mediat, është se ulja e tarifave doganore do të shpjerë në 'rrënimin' e prodhimit vendas, në falimentimin e tij, si rezultat i depresionit të çmimit në treg.

Por cila është vlefshmëria e argumentit në raport me problematikën e mprehtë të cilësisë së qeverisjes? A nuk po harxhojmë shumë energji negative duke diskutuar gjëra që nuk të shpien askund? A nuk duhet të fokusohemi më shumë

(vijon në faqen 3)

### Në këtë numër:

1. Intervistë me Enno Bozdo, Zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës *faqe 1-2*
2. Politika tarifore apo reforma standarde: Vlefshmëria e argumenteve *Engjëll Skreli faqe 1,3*
3. Integrimi jo si lugë floriri *Gjergj Buxhuku faqe 4*
4. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit: Sfida dhe Mundësi për Shqipërinë *Ditmir Bushati faqe 6-8*
5. Rezolutë e miratuar nga Kuvendi "Merastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit" *faqe 1,5*
6. Informacion mbi përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Marrëveshjen e Ndërmjetme (ad interim) *Inf. i depozit. në Kuvend faqe 9-12*
7. Nga Punimet e Kuvendit për muajin maj 2006 *faqe 13-14*
8. Nga Veprimtaria e Komisionit të Integrimit maj 2006 *faqe 14-16*
9. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 12 qershor - 3 korrik 2006 *faqe 17-19*

### REZOLUTË

#### ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM - ASOCIIMIT

Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 8.06.06

Kuvendi i Shqipërisë përshëndet nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit dhe vlerëson se ai përbën një moment historik në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje shënon kurorëzimin e përpjekjeve disavjeçare në afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit nis një fazë të re në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për përgatitjen e vendit për anëtarësim të plotë në BE, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe në zbatim e respekt të plotë të kritereve të Kopenhagenit dhe konkluzioneve të Samitit të Selanikut.

(vijon në faqen 5)

## Intervistë me Enno BOZDO Zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

(vijon nga faqja 1)

Kjo do të thotë se skemat e liberalizimit shqiptar të tarifave doganore nuk është vetëm ajo e reduktimit të tarifave doganore për një sërë produktesh industriale të konsideruara "të ndjeshme" (sensitive), tarifat e të cilave do të reduktohen në "0", gjatë një periudhe tranzitore prej 5 vjetësh, duke filluar nga fillimi i zbatimit të marrëveshjes. Pra përgjithësisht tarifat doganore për produktet industriale shkojnë menjëherë në "0" me fillimin e zbatimit të marrëveshjes, me përjashtim të atyre "të ndjeshme".

Veç kësaj reduktohen në mënyra të kombinuara edhe disa tarifa doganore për produktet e freskëta bujqësore, për produktet e industrisë ushqimore dhe të industrisë së verës dhe pijeve alkolike. Duhet theksuar se tarifat doganore, që janë bazë e reduktimeve me fillimin e zbatimit të marrëveshjes, janë tarifat e kombit më të favorizuar (MFN), të ndërtuara mbi bazën e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Pas kësaj paraqitje të shkurtër i kthehemi pyetjes: Efektet në buxhetin e shtetit?

Po, janë llogaritur saktë të gjitha efektet që do të rrjedhin në buxhetin e shtetit nga reduktimet e tilla të tarifave doganore, si gjatë periudhës negociuese, ashtu edhe për importet e vitit 2005. Pas llogaritjes natyrisht që ka nevojë edhe për disa analiza dhe vlerësime të tilla, mbi bazën e pyetjes: a do të reduktohen të ardhurat doganore për çdo mall të nisur nga vendet e Bashkimit Europian drejt Shqipërisë, për të cilat parashikohet reduktimi i tarifave doganore apo jo?

Duke i dhënë në fillim përgjigje kësaj pyetje, pra që reduktim tarifash do të kenë vetëm produktet të cilat plotësojnë kushtet e origjinës europiane të produktit, do të përcaktojmë se sa është realisht efekti i pritshëm në buxhet.

Për të përfituar tarifën preferenciale të reduktuar, çdo produkt duhet të shoqërohet me certifikatën e origjinës preferenciale, certifikatë e cila lëshohet nga prodhuesit, në çastin e prodhimit dhe certifikohet nga organet doganore të Bashkimit Europian, vetëm kur produktet kanë përfituar statusin e të qajturit produkt i prodhuar në një nga vendet e Bashkimit Europian. Mbi bazën e këtij parimi rezulton se, mbështetur në importin faktik të vitit 2005, efekti në buxhetin e shtetit do të ishte në rreth 23-24 milion Euro. Kjo pasi koeficienti i pranimit të origjinës, është përgjithësisht në nivelet ndërmjet 40-45%, pra vetëm 40-45% e importeve faktike nga vendet e Bashkimit Europian janë produkte origjinuese.

Natyrisht që kompensimi i kësaj shume është objektiv i politikave fiskale, në mënyrë që kjo ulje të mos shkaktojë efektin negativ në uljen e investimeve publike. Në këtë pikë, përveç mbështetjes buxhetore nga Bashkimi Europian, i cili edhe ky është një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, janë edhe një sërë masash që sigurojnë mbylljen e kësaj "të çare", masa të tilla si ndryshimi i strukturës së taksave, puna më e kualifikuar ndaj evazionit fiskal (shenjat e para të së cilës ndjehen).

2. *A ekziston ndonjë studim impakti i Ministrisë së Ekonomisë në lidhje me efektet e pritshme që do të ketë Mar-*

*rëveshja e Përkohëshme për biznesin dhe qytetarin shqiptar?*

Duke vazhduar paraqitjen e përgjigjes së pikës së parë, është nevojshme të spjegoj, se me mbështetjen e programit CARD-s të Bashkimit Europian, Ministria e Ekonomisë ka udhëhequr disa studime që kanë të bëjnë me gjetjen e rrugëve jo vetëm për të mbuluar efektet në buxhetin e shtetit por më gjerë për t'i dhënë zgjidhje kryesisht rritjes së konkurrenshmërisë së produkteve shqiptare, sidomos në tregun shqiptar dhe në eksport. Kjo për më tepër që edhe në kushtet e marrëveshjes së tregtisë së lirë ekonomia shqiptare të ngushtojë veçanërisht defiçitin tregtar, të sigurojë rritjen e prodhimit vendas, rritjen e cilësisë dhe garantimin e saj, etj.

Studime si:

1. Zëvendësimi i importeve me prodhime vendi;
2. Financimi i eksporteve, me synim rritjen, garantimin dhe nxitjen e tyre;
3. Marketingu dhe shpërndarja e produkteve bujqësore. Konkluzionet e këtyre studimeve tashmë janë paraqitur dhe Ministria e Ekonomisë ka filluar fazën përmbyllëse, të iniciativave ligjore për marrjen e masave përkatëse. Kështu do të fillohet me ngritjen e agjencisë së kreditimit për eksportin, etj.

Lidhur me përfitimet apo humbjet e mundëshme nga zbatimi i tregtisë së lirë, natyrisht që vulën përfundimtare do ta japë tregu, por i gjithë procesi është zhvilluar dhe do të zhvillohet me synimet që përfituesi i parë të jetë konsumatori, të jetë ekonomia shqiptare. Është tashmë e qartë që prodhues apo operatorë të tjerë në treg, të cilët nuk do të përballojnë konkurrenshmërinë e produkteve të tyre në tregun tashmë global rajonal apo më gjerë, konkurrenshëri që nuk përbën vetëm "kosto", por përmban edhe elemente të tjerë si siguria ushqimore, sipas standarteve europiane; normat e konformitetit, standartet e produkteve, etj.

Mbështetur në klimën që siguron marrëveshja e stabilizim asociimit në përgjithësi dhe ajo për tregtinë e lirë në veçanti, me siguri që do të sjellë efekte vetëm pozitive në rritjen e investimeve në përgjithësi dhe atyre të huaja në veçanti, rritjen e punësimit, rritjen e prodhimit dhe eksportit; pra rritjen e mirëqënies në përgjithësi.

Rezultatet e mësipërme të pritshme nuk janë vetëm paraqitje që burojnë nga eksperiencat tashmë botërore, por edhe nga vërtetimi në praktikë i efekteve të deritanishme të marrëveshjeve të tregtisë së lirë që tashmë vendi ynë zbaton me të gjithë vendet e rajonit. Natyrisht që çdo operator tregu që nuk merr masat e nevojshme për përshatatjen e veprimtarisë së tij me standartet dhe normat e Bashkimit Europian në një periudhë shumë të shkurtër kohe do të jetë përpara vështirësive shumë të mëdha, por ndërkohë duhet të evidentojmë se janë të shumtë operatorët që i kanë kthyer industrinë e tyre jo vetëm mbështetur në teknologjitë më të përparuara, por kanë vendosur edhe norma dhe standarde prodhimi dhe sigurie sipas standardeve më të njohura europiane, të certifikuar po nga institucione prestigjioze ndërkombëtare.

# Politika tarifore apo reforma standarde: Vlefshmëria e argumenteve

(vijon nga faqja 1)

në përmirësimin e qeverisjes për të gjithë, t'a matim atë dhe të kërkojmë llogari nëse ajo nuk përmirësohet? Këto janë disa pyetje që të mundojnë kur sheh se diskutohet pa fund për tarifatat doganore dhe pak ose aspak për vendosjen e kasave në bare e restorante!

Le ti marrim çështjet me radhë:

*Çmimi i tregut është përgjithësisht indiferent ndaj uljes së tarifave doganore.*

Argumenti i parë lidhur me dëmin që shkaktojnë importet me çmime të ulta (në këtë rast, për shkak të tarifave të ulta ose zero) është ulja e çmimit të tregut. Në fakt, cila është e vërteta ekonomike? Në të shumtën e rasteve, del se ulja e tarifave doganore nuk shoqërohet me uljen e çmimeve në treg; pra çmimi është 'indiferent' ndaj një sinjali që gjithësi duhet të ndikonte në uljen e çmimit të tregut. *Struktura monopolistike dhe informaliteti spjegojnë misterin e 'indiferencës' së çmimit të tregut.*

Sipas teorisë ekonomike, sasia e stërmadhe e produkteve të importuara me një tarifë doganore më të ulët duhet të ndikonte mbi çmimin e tregut, duhet ta ulte atë. Ndërkaq, në shumicën e rasteve kjo nuk ndodh. Si spjegohet?

Një shqyrtim i hollësishëm i hapësirës mes traht të doganës dhe xhepit të konsumatorit do të evidentonte një sërë faktorësh spjegues. Ndërkaq, të paktën dy faktorë spjegojnë pjesën më të madhe të 'misterit' se pse konsumatori nuk e ndjen uljen e tarifës doganore: (i) struktura monopolistike (oligopolistike) e tregjeve dhe (ii) kontrabanda në traun e doganës.

Në rastin e një strukture konkurruese të tregjeve, importi i një sasive të stërmadhe produktesh me çmim më të ulët (pa tarifë doganore) duhet të reflektohej në uljen e çmimit të tregut; në këtë rast i duhej qarë halli edhe biznesit. Në rastin e një strukture monopolistike (oligopolistike) të tregut, firmat e mëdha merren vesh për të mos ulur çmimin e tregut. Struktura monopolistike e tregut në Shqipëri spjegov në një masë të madhe 'indiferencën' e çmimit në nivelin e konsumatorit.

Më tej, kontrabanda në përmasa të konsiderueshme me të cilën është 'ambjentuar' tashmë çmimi nuk e ndjen uljen e tarifës doganore (në fakt malli edhe më parë hynte pa tarifë; tashmë ulja ose heqja e tarifës vetëm sa formalizohet). Në këtë mënyrë pra çmimi mbetet po ai.

*Nuk mund të ketë politika tarifore të efektshme pa reforma standarde.*

Nëse çmimi është 'indiferent' ndaj një sinjali ekonomik, nëse ekonomia është e mpirë dhe nuk reagon ndaj ngacmimeve të jashtme, atëherë asaj duhet t'i kthehet ndjeshmëria. Dhe ndjeshmëria kthehet me reforma standarde me përmirësimin e qeverisjes.

Kaufman – ekonomist në Bankën Botërore - dhe të tjerë kanë përgatitur një model për matjen e nivelit të qeverisjes, duke marrë në konsideratë gjashtë dimensione:

- Procesi politik dhe llogaridhënia e politikës (procesi politik, liritë civile, zgjedhjet, etj.);
- Stabiliteti politik (mundësia e rrëzimit të qeverisë me dhunë);
- Efektiviteti i qeverisjes (kompetenca dhe pavarësia e administratës, mënyra se si qeveria i përmbahet angazhi-

meve për reformë);

- Cilësia rregullatore (politikat e tregut dhe ngarkesa rregullatore);

- Shteti ligjor (besimi tek rregullat dhe respektimi i tyre, gjykatat dhe kontratat);

- Kontrolli i korrupsionit (perceptimi i korrupsionit, i kuptuar si shpërdorimi i pozitës publike).

Burimi: <http://www.worldbank.org/wbi/governance/govdata2002>

Sipas burimesh të kryqëzuara e të besueshme informacioni (sipas pasqyrës së mëposhtme), rezulton se Shqipëria ka probleme të mëdha të qeverisjes, sidomos përsa i përket besimit në rregulla dhe zbatimit të tyre, gjendjes së gjykatave, dhe korrupsionit të lartë. Probleme ka edhe në nivelin e administratës e reformave pro treg; krijimin e kushteve të barabarta për konkurrencë; përveç stabilitetit politik dhe procesit politik.

*Treguesit e qeverisjes*

*0 situatë kritike, 100 situatë ideale*

	Shqipëria	Italia	Hollanda
Procesi politik dhe llogaridhënia e politikës	49.5	83.8	98.0
Stabiliteti politik	30.3	73.0	95.7
Efektiviteti i qeverisjes	38.1	80.4	99.0
Cilësia rregullatore	41.2	83.5	99.0
Shteti ligjor	17.5	75.8	94.8
Kontrolli i korrupsionit	23.2	76.3	96.4

Burimi: <http://www.worldbank.org/wbi/governance/govdata2002>

Sipas pasqyrës së mësipërme, duket se distanca nga Italia është shumë e madhe, ndërsa distanca nga Hollanda është e pa imagjinueshme.

Në kushtet e një niveli të tillë të ulët të qeverisjes, çdo politikë e diferencuar, sektoriale apo produkti – duke përfshirë edhe politikat e mbrojtjes tarifore – do të shoqërohej me aksidentim të mëtejshëm të fushës së lojës së biznesit, në favor të disave dhe në disfavor të shumë të tjerëve.

*Nuk kemi pse të shpikim rrotën: më shumë vëmendje në përmirësimin e qeverisjes për të gjithë.*

Sot ka një konsensus të gjerë mes ekonomistësh, por gjithnjë e më shumë edhe mes politikanësh, se politika e hapjes shoqërohet me rritje ekonomike më të shpejtë se një politikë proteksioniste. Ky konsensus mbështetet edhe nga të dhëna statistikore të mjaftueshme. Në fakt, zor se mund të gesh ndonjë vend të vogël e në zhvillim (siç është Shqipëria) që të jetë zhvilluar përmes politikës së mbrojtjes tarifore. Pra nuk ka bazë teorike dhe evidencë empirike që të jetë në favor të zhvillimit, rritjes ekonomike përmes politikës tarifore. Ndërkaq, ka argumente dhe evidenca të qarta, deri në 'common sens', se qeverisja e mirë është faktori themelor i zhvillimit të biznesit dhe rritjes ekonomike të qëndrueshme. Prandaj më shumë vëmendje në përmirësimin e qeverisjes për të tërë!



## INTEGRIMI JO SI LUGË FLORIRI

Ka shumë e shumë vjet, që dëgjojmë politikën të flasi pafund për integrimin dhe të mirat, që do t'u jepen shqiptarëve. Dhe mirë bën. Shanset, që jepen në Europën e Bashkuar pa mëdyshje janë të mëdha për individin kushdo qoftë ai. Pavarësisht se në mendjen e shqiptarëve integrimi është vizatuar si çasti kur ata nuk do të jenë më duke mbajtur rradhët dhe përçmimin në ambasada për viza ose duke u lutur për të gjetur vendin më të mirë në gomone ku era e detit ndjehet më pak. Shkurt, integrimi në mendjen e tyre ka qenë dhe ende është një mënyrë më e lehtë për t'u larguar nga vendlindja. Prandaj edhe Po-ja shqiptare ka qenë e thellë, kur janë pyetur nëse e dëshirojnë përfshirjen. Në ndryshim nga vendet e tjera të cilat kanë patur mëdyshjet e tyre. Dhe kjo e fundit ka një shkak. Shkak, që duhet na bëjë ne, dhe mbi të gjitha politikën, të ndihet keq kur është mburrur për shkallën e lartë të dëshirës për t'u integruar. Sepse, nuk mund të jetë shenjë e mirë të kërkosh integrimin si mënyrën më të lehtë për t'u larguar nga sytë këmbët nga vendi yt. Kjo nuk tregon vlerë por pikërisht antivlerë në ndërtimin e institucioneve shtetërore, që detyron qytetarët e tij të largohen me dëshirë dhe falenderime nga shtëpia. Sigurisht faktori ekonomik është baza, që shërben për të arritur në një përfundim të tillë të dhimbshëm. Mungesa e aftësisë së punësimit të më shumë se 50 mijë forcave të reja të punës, që çdo vit dalin në treg, shërbimet publike të dobëta, rendi, arsimi, shëndetësia, uji, dritat, rrugët, etj., janë shtytësit vendimtarë të marrjes së vendimit të vështirë për largimin nga vendi. Arsyet e mësipërme duhet të jenë të thella, përderisa pas marrjes së vendimit pranohen të gjitha mënyrat për t'u larguar. Deri në rrezikun për jetën. Rrezik, që njeh deri më tash me qindra dhe mijëra viktima. Kup-tohet, që në kushte të tilla, Po-ja e shqiptarëve është e menduar mirë. Por, njëkohësisht është edhe e dhimbshme dhe e turpshme. Sepse, i bie që të mos kenë se çfarë të humbin. Prandaj ndodh ndryshe me kombet e tjerë, që dinë të thonë edhe Jo dhe nuk janë kaq entuziastë në përfshirjen e tyre më europianët e tjerë. Siç duket ata kanë edhe se çfarë të humbin. Arsyet tjetër e entuziazmit shqiptar për integrimin është mungesa e vazhduar e informacionit. Bashkuar me ëndrrën e vjetër të shqiptarëve të prodhuar dhe kultivuar me bollëk nga izolimi i tmerrshëm komunist për të lëvizuar drejt bollëkut perëndimor, ende një pjesë e ndjeshme e qytetarëve kanë iluzionin e Europës, ku mund të shkojnë me lugë floriri në brez. Shumatorja e arsyeve të mësipërme shpjegon se çfarë po ndodh në Shqipëri në pragun e nënshkrimit të marrëveshjes së stabilizim asociimit më BE-në. Kuptohet, që të mburresh se shqiptarët janë partizanë të paepur të integritit sepse janë të bindur se vendi i tyre nuk i mban dot, është e hidhur. Kjo do të thotë në thelb se psikologjia e pamundësisë së të bërit shtet është e fortë te ne. Nuk duhet shumë mund për të gjetur shembuj të shumtë për të arsyetuar sa më sipër. Gjithashtu, kjo do t'i jepte fund çdo përçapjeje për të shpjeguar se përse duhet të kemi kujdes dhe të përgatitemi për bash-

kimin e mirëpritur me Europën. Në fund të fundit shqiptarët përpara se të jenë të tillë, janë njerëz, që duhet të jetojnë jetën, që nuk është pafundësisht e gjatë. Kështu përderisa mendojnë se në vendin e tyre nuk mund të gjejnë lumturinë e ëndërruar ose më mirë të themi iluzionin e kërkuar, atëhere nuk mund të ketë asnjë bindje për të qëndruar në tokën e tyre.

Por, kjo është vetëm ana e zezë e medaljes shqiptare. Jeta e një kombi është shumë më e gjatë sesa një brez që jeton në disa dhjetvjeçarë. Nëse vështirësitë e sotme do të na errësonin sytë për të mos llogjikuar asgjë përpara hyrjes në BE, në kuptimin për të ditur sesi duhet të vepronim për të përfituar sa më shumë dhe humbur sa më pak, do të gabonim rëndë. Sepse, çdo proces aq më shumë ngjarje të tilla madhore, nuk kanë vetëm përfitime por edhe humbje nëse nuk do të dish të veprosh. Dhe përpara se të veprosh do të duhet të të shkojë në mendje një gjë e tillë. Në rradhë të parë vendimarrësve të këtij vendi. Ata duhet të shikojnë më larg se e sotmja. Detyrimisht më larg. Nesër kur të jemi të integruar dhe nuk do të kemi më vështirësitë e përditshme të sotme do të përballemi me pyetjen e fëmijëve tanë se përse janë të detyruar të jenë gjithmonë qytetarë të dorës së dytë në Europë. Jo me fjalë natyrisht, por me vepra. Sepse, është shumë ndryshe nëse hyn në BE si shtet nga të bashkuarit si individë. Sot mbase nuk nuk e mendojmë, por nesër kur të shikojmë dhe provojmë se shqiptarët do ta kenë shumë më vështirë se të tjerët të jenë pronarë edhe në vendin e tyre, kur të ndiejmë se do të jemi të detyruar të bëjmë shërbëtorin për të tjerët pavarësisht se ku jemi, do të jetë vonë. Kjo është çështja më e rëndësishme, që duhet të na shqetësojë të gjithëve sot, pikërisht në ditët kur pritet fillimi i procesit të rëndësishëm. Nuk mund të mbyllet sytë ndaj të nesërmeve edhe pse e sotmja është e vështirë. Sepse, nëse gjykojmë më thellë do të arrijmë në përfundimin se i kemi të gjitha mundësitë për të qenë dinjitozë në gjirin e kombeve të tjerë. Mjafton të vlerësojmë se ku ishim para vetëm disa vitesh dhe ku jemi sot. Shqipëria dhe kombi shqiptar në tërësi megjithë pikën shumë të ulët të fillimit dhe vështirësitë e panumërta të qëllimshme ose objektive ka nisur në mënyrë të pandalshme rrugën e ngritjes. Kujtojmë se sot shqiptarët janë një komb 7 milionësh, që po bashkohet për të mirën e të gjithëve. Një komb i tillë nuk është më i parëndësishëm në gjirin e Europës. Kujtojmë se sot psikologjikisht përparimi i kombit është i dallueshëm. Vetë hapja me botën ka shërbyer për të kuptuar krejt ndryshe realitetin. Edhe mirëqenia jonë është ngritur ndjeshëm. Sëbashku me gjithçka më sipër edhe vetë nocioni i shtetit ka filluar të dallohet. Është e mjaftueshme për të patur të drejtën për t'i tërhequr vëmendjen politikës sonë që të shikojë përtej firmës së integritit. Duhet të përgatitemi të shohim se integrimi nuk është vetëm një festë por edhe një sfidë që duhet përballuar. Dhe nuk kemi kohë për të humbur, sepse kemi humbur shumë deri më tash. Por më mirë vonë sesa kurrë.

**Nga Gjergj Buxhuku**

## REZOLUTË

### “Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit”

Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 8.06.06

*(vijon nga faqja 1)*

Kuvendi i Shqipërisë është i ndërgjegjshëm se zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit është vendimtar dhe themelor për përparimin e mëtejshëm dhe përshpjetimin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Kuvendi është i ndërgjegjshëm se në rrugën e reformave drejt integritit të mëtejshëm nuk ka rrugë të shkurtra (short – cuts). Kuvendi shpreh gadishmërinë dhe angazhimin e tij të plotë për të mbështetur përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e re institucionale me Bashkimin Europian, veçanërisht në drejtim të forcimit të shtetit ligjor, të të drejtave të njeriut, të konsolidimit të ekonomisë së tregut, të luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar, në ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative në realizimin e të gjitha reformave, të cilat sjellin rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Një vëmendje dhe angazhim të veçantë Kuvendi i Shqipërisë do të tregojë për realizimin e reformës zgjedhore, me qëllim realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përfaqësimit e drejtë të vullnetit të qytetarëve. Nga ana tjetër, Kuvendi i kërkon BE-së dhe vendeve anëtare që, pas nënshkrimit dhe ratifikimit nga ana e Republikës së Shqipërisë të Marrëveshjes së Ripranimit dhe në përputhje me konkluzionet e Samitit të Selanikut, të vlerësojë masat për një liberalizim në rritje të lëvizjes së personave, si një aspiratë themelore e popullit shqiptar dhe si një tipar konceptual i integritit europian.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh vullnetin e tij për të mbështetur intensifikimin e bashkëpunimit me strukturat e Bashkimit Europian, në veçanti me vendet anëtare, Komisionin Europian dhe Parlamentin Europian. Kuvendi shpreh angazhimin e tij për një proces të shpejtë të ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit nga parlamentet e vendeve anëtare dhe për dhënien e pëlqimit nga Parlamenti Europian. Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë hartimin e një axhende konkrete për etapat e mëtejshme në procesin e integritit europian, përfshirë këtu edhe objektivat kohorë dhe cilësorë për marrjen e statusit të kandidatit.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh dëshirën e tij që nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit të shërbejë si një nxitje e motivim i fuqishëm për vendet e rajonit në rrugën e tyre të integritit europian dhe të shënojë një cilësi të re në marrëdhëniet midis vendeve tona. Kuvendi i Shqipërisë do të vijojë të mbështesë me vendosmëri politikën konstruktive të Republikës së Shqipërisë në rajon, duke synuar një rajon më stabil, më të integruar e me mirëqenie në rritje.

Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë t’ia përcjellë këtë Rezolutë vendeve anëtare të BE-së, Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian.

## Marrëveshja e Stabilizim Asociimit: Sfida dhe Mundësi për Shqipërinë

Nëshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (më poshtë "MSA") midis Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian nga ana tjetër, më 12 qershor 2006, përveç detyrimeve në planin politik, ligjor, ekonomik dhe institucional do të shoqërohet edhe me një kuadër të ri të marrëdhënieve BE-Shqipëri, duke shënuar stadin më të avancuar të kësaj marrëdhënie. Në mënyrë që të kuptohet sa më drejtë kjo marrëdhënie është e rëndësishme të analizohet baza ligjore mbi të cilën lidhet kjo marrëveshje, objektivat kryesore që synon të arrijë, kuadri institucional dhe procedurat e hyrjes në fuqi si dhe veçoritë e Marrëveshjes së Përkohshme (më poshtë "MP"), e cila, do t'i paraprijë hyrjes në fuqi të MSA-së.

### *Natyra e marrëveshjeve të asociimit*

Marrëveshjet e asociimit lidhen mbi bazën e Nenit 310 (ish neni 238) të Traktatit të KE-së, i cili parashikon se: *"Komuniteti mund të përfundojë, me një ose më shumë shtete ose organizata ndërkombëtare, marrëveshje që krijojnë një asociim që përmban të drejta dhe detyrime të ndërsjellta, veprime të përbashkëta dhe procedura specifike"*.

Fakti që marrëveshjet e asociimit në mënyrë që të përfundohen kërkojnë një votë unanime nënkupton se marrëveshjet përmbajnë çështje më shumë se sa tregtare. Marrëveshjet tregtare - sikundër Marrëveshja e Përkohshme që do t'i paraprijë hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit - mbështeten në Nenin 133 (ish neni 113) të Traktatit të KE-së dhe kërkojnë shumicë të kualifikuar.

Gjithashtu, fakti që nuk ka ndonjë kufizim gjeografik për shtetet të cilat kërkojnë të kenë një regjim asociimi me BE-në do të thotë se 'asociimi' është diçka më pak se anëtarësimi, i cili - sipas Nenit 49 të Traktatit të BE-së - është i kufizuar vetëm për 'shtetet europiane'. Me pak fjalë, 'asociimi' është një regjim midis marrëveshjes tregtare dhe antarësimit. Është kjo arsyeja që ish presidenti i Komisionit Europian Walter Hallstein deklaronte në mënyrë të përsëritur se *"asociimi mund të jetë çdo gjë ndërmjet anëtarësimit të plotë minus 1% dhe një marrëveshje tregtare dhe bashkëpunimi plus 1%"*.

Gjykata Europiane e Drejtësisë në çështjen *Demirel* pati mundësi të shtjellojë më tej konceptin e 'asociimit' duke e përkufizuar atë si: *"Një mjet që krijon lidhje speciale e të privilegjuara të vendeve të treta me Komunitetin, të cilat nga ana e tyre marrin pjesë në sistemin komunitar. Nga ana tjetër, Komuniteti, ba-*

*zuar edhe në nenin 238, duhet të garantojë marrjen e masave për të gjitha fushat që mbulon traktati"*.

Gjithsesi çështjet që janë debatuar më gjatë në literaturë kanë të bëjnë me faktin se sa larg shkojnë lidhjet që krijohen nga këto marrëveshje me Komunitetin dhe se çfarë nënkupton 'shumë integrim', i cili duhet të përfshihet në marrëveshjet e asociimit, si mundësi për një aderim potencial të shtetit të asociuar në BE.

Përkundër qasjes doktrinare, praktika dëshmon se marrëveshjet e asociimit janë të formave të ndryshme. Ato mund të përfshijnë krijimin e një zone të tregtisë së lirë, sikundër parashikohet në MSA-në me Shqipërinë, ose të një bashkimi doganor. Një gjë e tillë mund të arrihet brenda një periudhe kohe të arsyeshme dhe në mënyrë asimetrike. Pra, regjimi i asociimit mund të jetë *minimalist* dhe të përfshijë diçka më tepër se sa tregtia e lirë me mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit me kalimin e kohës. Në mënyrë alternative, mund të shfaqet në trajtën e një *marrëdhënie ekonomike të avancuar* duke u mbështetur në bashkimin doganor dhe duke e zgjeruar më tej bashkëpunimin në të gjitha fushat e aktivitetit të KE-së.

### *Objektivat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit*

Një ndër objektivat kryesorë të MSA-së është vendosja e një kuadri të përshtatshëm për dialogun politik midis BE-së dhe Shqipërisë. Një tjetër objektiv është zgjerimi i tregtisë së ndërsjellë në mënyrë progresive duke i shtrirë efektet në faza të ndryshme të asociimit. Zhvillimi dinamik i bashkëpunimit ekonomik dhe prosperiteti i Shqipërisë me qëllim përfundimin e tranzicionit dhe ndërtimin e një ekonomie tregu funksionale mbetet një objektivi i rëndësishëm i MSA-së.

Bashkëpunimi rajonal është një objektivi themelor i MSA-së, çka në fakt e bën të dallueshëm edhe nga marrëveshjet e asociimit që BE-ja ka lidhur me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Qasja rajonale është e kushtëzuar nga disa faktorë, të cilët mund të përmbliken në ato të funksionimit të mirëfilltë të institucioneve dhe stabilitetit politik, luftës kundër korrupsionit dhe krijimit të një zone më të madhe të tregtisë së lirë.

Një tjetër objektivi i MSA-së është bashkëpunimi në fusha të ndryshme. Politikat e bashkëpunimit do të synojnë zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm në Shqipëri duke siguruar që çështjet e mjedisit të jenë të përfshira që nga fillimi dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin harmonik social. Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kuadër rajonal bashkëpunimi duke mbajtur parasysh *acquis*

*(vijon në faqen 7)*



## Marrëveshja e Stabilizim Asociimit: Sfida dhe Mundësi për Shqipërinë

(vijon nga faqja 6)

*communautaire*. Politikat e bashkëpunimit do të shtrihen në fusha të tilla si: ekonomia dhe tregtia, statistikat, veprimet bankare, sigurimet dhe shërbime të tjera financiare, auditi dhe kontrolli financiar, nxitja dhe mbrojtja e investimeve, industria, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, turizmi, bujqësia dhe sektori agro-industrial, peshkimi, doganat, tatimet, çështjet sociale, arsimi dhe trajnimi, kultura, industria audio-vizuale, shoqëria e informacionit, rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik, informacioni dhe komunikimi, transporti, energjia, mjedisi, kërkimi dhe zhvillimi teknologjik, zhvillimi rajonal dhe lokal, administrata publike.

Bashkëpunimi në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë përbën një objektivi të dallueshëm të MSA-së. Marrëveshjet e asociimit të lidhura përpara hyrjes në fuqi të Traktatit mbi Bashkimin Europian, si traktati që futi shtyllën e tretë mbi bashkëpunimin në këto fusha, nuk e parashikojnë një gjë të tillë. Arsye tjetër për përfshirjen e bashkëpunimit në këto fusha është komunitarizimi i pjesshëm i shtyllës së tretë nga Traktati i Amsterdimit, i cili shtoi rëndësinë e fushës lidhur me vizat, azilin, menaxhimin e kufijve, migrimin, dhe politikat e tjera të lidhura me lëvizjen e lirë të personave. Për të arritur objektivat financiare të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Europiane e Investimeve. Neni 113 i MSA-së përcakton se *“asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik”*.

Së fundmi, objektivi ndoshta më i rëndësishëm i MSA-së është krijimi i kuadrit të përshtatshëm për integrimin gradual të Shqipërisë në BE. Paragrafi i fundit i Preambulës së MSA-së rikujton *“gatishmërinë e Bashkimit Europian për ta integruar Shqipërinë sa më plotësisht të jetë e mundur në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Europës, si dhe statusin e saj si kandidat i mundshëm për antarësimin në BE në bazë të Traktatit të Bashkimit Europian dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Europian në qershor të vitit 1993, në varësi të zbatimit të suksesshëm të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht për sa i përket bashkëpunimit rajonal”*. Ky formulim i kujdesshëm shmang çdo interpretim se MSA-ja garanton automatikisht të drejtën e aderimit të Shqipërisë në BE.

*Kuadri institucional dhe procedurat e hyrjes në fuqi të MSA-së*

*MSA-ja parashikon krijimin e Këshillit të Stabilizim Asociimit si një organ me fuqi vendimarrëse, zgjidhës i konflikteve që lindin mes palëve dhe si “administrator” i përgjithshëm i MSA-së. Këshilli i Stabilizim Asociimit përbëhet, nga njëra anë, nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Europian dhe anëtarë të Komisionit të Komuniteteve Europiane, dhe anëtarë të Qeverisë Shqiptare, nga ana tjetër. Përfaqësimi në Këshill do të jetë në nivel politik (në nivel ministrash). Eksperienca e marrëveshjeve ndërkombëtare në përgjithësi dhe atyre të asociimit në veçanti tregojnë, Këshilli operon mbi bazën e paritetit, për pasojë, vendimarrja kalon përmes kompromisit të palëve pjesëmarrëse.*

*Pjesë e rregullimit institucional të MSA-së është edhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim Asociimit, i cili, do të jetë forumi i përbashkët i deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Europian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Përfaqësimi i palës shqiptare do të jetë gjithëpartiak, duke siguruar në këtë mënyrë kanalizimin e pikpamjeve të shumicës dhe pakicës parlamentare në këtë forum.*

*MSA-ja do të hyjë në fuqi në bazë të procedurave kushtetuese të palëve. Nënshkrimi i saj më 12 qershor 2006, i hapi rrugën procedurave të ratifikimit. Në rastin e Shqipërisë, ratifikimi në Kuvend dhe më pas botimi në Fletoren Zyrtare, konsiderohen si hapa ezaurues të procedurave kushtetuese. Ndërkohë, që Marrëveshja do t'i nënshtrohet procedurave të ratifikimit në Parlamentin Europian dhe në parlamentet e Shteteve Anëtare të BE-së. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave Marrëveshja do të hyjë në fuqi.*

*Marrëveshja e Përkohshme*

Në pritje të përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të MSA-së, dispozitat që lidhen me tregtinë zbatohen në bazë të MP-së që Komuniteti lidh me Shqipërinë. E thënë ndryshe, MP-ja e cila do t'i paraprijë hyrjes në fuqi të MSA-së mbulon fusha të cilat bien në rrezën e veprimit komunitar.

Komiteti i Përbashkët i ngritur sipas Marrëveshjes midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik të vitit 1992, do të ushtrojë kompetencat dhe do të përmbushë detyrat që MSA-ja i ngarkon Këshillit të Stabilizim Asociimit ose Komitetit të Sta-

(vijon në faqen 8)

## Marrëveshja e Stabilizim Asociimit: Sfida dhe Mundësi për Shqipërinë

(vijon nga faqja 7)

bilizim Asociimit.

MP-ja shënon një hap tjetër të rëndësishëm i cili lidhet me reciprocitetin e liberalizmit nga të dyja palët<sup>2</sup>. Shqipëria do të fillojë të liberalizojë më shumë tregun për produktet komunitare ndonëse ky do të jetë një proces i shtrirë në kohë. Dhjetë vjet nga hyrja në fuqi e MP-së parashihet krijimi i zonës së tregtisë së lirë BE-Shqipëri. Gjithashtu, sanksionohet detyrimi i Shqipërisë për të nënshkruar një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Turqinë, e cila është pjesë e bashkimit doganor të KE-së.

MP-ja mbështet në parimet dhe rregullat e OBT-së, më konkretisht, në nenin XXIV të GATT '94, i cili rregullon marrëdhëniet e palëve që nënshkruajnë Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë brenda dhe jashtë kësaj zone. Megjithatë, marrëveshjet e OBT-së që kanë të bëjnë me antidumping apo masat kundërbalancuese do të jenë sërish udhërrëfyese të rregullimeve të parashikuara në këtë marrëveshje për këto çështje specifike. Rregullat e origjinës për të përfituar certifikatën EUR 1 përcaktohen në mënyrë të detajuar në Protokollin 4 që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje. Për më tepër, me krjimin e kushteve të përshtatshme ekonomike, Këshilli i Stabilizim Asociimit do të konsiderojë futjen e Shqipërisë në sistemin e *kumulimit diagonal* të origjinës.

MP-ja ndalon diskriminimin fiskal për të gjitha taksat që aplikohen në territoret respektive. Në parim, MP-ja ndalon masat që sjellin një kufizim të tregtisë si: liçensa, certifikata prodhimi, masa që lidhen me inspektimin dhe kontrollin, rimbursimin e barnave, dhe rregullimet teknike etj. Përafrimi i legjislacionit me *acquis communautaire* do të përqendrohet në fushat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, pronësisë intelektuale dhe industriale, prokurimit publik dhe doganave.

Sikurse shihet qartë, MP-ja mbulon dhe rregullon një gamë më të gjerë çështjesh. MP-ja parasheh jo vetëm një regjim liberalizues për tarifatat dhe kuotat tarifore në një gamë më të madhe produktesh, por përmban edhe detyrime të veçanta për të garantuar harmonizimin e rregullave që lidhen ngushtësisht me çështjet e tregtisë. Marrëdhënia reciproke midis palëve do të vendoset në mënyrë graduale, pasi Shqipëria do të vazhdojë të mbajë një regjim kufizues për disa nga produktet industriale, bujqësore dhe peshkun. Për shembull, një regjim i veçantë rregullues parashikohet për

verën, hekurin dhe çelikon si edhe për produktet e përpunuara bujqësore.

Ajo që mund të thuhet në analizë të fundit është se MSA-ja vendos një rregjim të ri juridik dhe kuadër institucional të përbashkët që pritet të sjellë përfitime të rëndësishme për qytetarëve shqiptarë, duke lejuar mundësi zgjerimi të tregtisë me vendet e BE-së nëpërmjet aplikimit gradual të standardeve europiane, përmirësimin e klimës së biznesit dhe hapjen e vendeve të reja të punës, cilësi në ofrimin e shërbimeve dhe zgjedhjeve për konsumatorin si dhe avantazhe në lehtësimin dhe liberalizimin e lëvizjes së shtetasve shqiptarë.

MSA-ja ofron një integrim gradual të Shqipërisë në funksion të qëllimit final, anëtarësimin në BE. Për pasojë, zbatimi me përpikmëri i detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja duhet kuptuar në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, modernizimit institucional dhe avancimit në etapat e mëtejshme të procesit të integritimit europian. Në të njëjtën kohë, zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja duhet të vijë paralelisht me përmirësimin dhe fuqizimin e kapaciteteve administrative, të nevojshme për t'i kthyer këto detyrime në energji pozitive për zhvillimin e vendit.

<sup>1</sup> Çështja 12/86, *Meryem Demirel v Stadt Schwabisch Gmund*, ECR 3719, 1987.

<sup>2</sup> Regjimi autonom preferencial i akorduar nga Rregullorja e KE-së 2007/2000 do të zëvendësohet gradualisht me një regjim reciprok, ku të dyja palët garantojnë akses të lirë në tregjet reciproke. Pikërisht ky regjim është në thelb të MSA-së dhe të MP-së të nënshkruara midis BE-së dhe vendeve të rajonit.

**Ditmir Bushati**



# Informacion mbi përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Marrëveshjen e Ndërmjetme (ad interim)

(Informacion i depozituar në Kuvend)

## *ÇFARË ËSHTË MSA-JA?*

Në muajin qershor 2006 pritet të nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Komunitetin Europian.

Marrëveshja është një instrument me anë të të cilit Shqipëria, në një marrëdhënie të re kontraktuale me Bashkimin Europian angazhohet për realizimin e një sërë reformash, politike, ekonomike dhe sociale, me synim arritjen e qëllimit final të përafrimit të vendit tonë me standardet Europiane.

MSA përmban shumë kapituj që përfaqësojnë formulime të sakta dhe ligjore mbi dialogun politik dhe bashkëpunimin rajonal midis palëve, dispozitat tregtare lidhur me liberalizimin progresiv të këmbimeve, liritë komunitare dhe bashkëpunimin në fushat prioritare, me theks në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendëshme. Në mënyrë të përcaktuar janë parashikuar procedurat dhe mënyrat e realizimit të lëvizjes së lirë të mallrave si produktet industriale, bujqësore apo të peshkut, lëvizja e punëtorëve, vendosjet e kompanive apo të filialeve të tyre, mënyra e ofrimit të shërbimeve, procesi i përafrimit të legjislacionit, rregullat e sigurimit të konkurrencës së lirë e të ndershme apo çështjet e drejtësisë dhe sigurisë, etj.

Pjesë integrale të marrëveshjes janë dhe Anekset dhe Protokollet e saj, si dhe Deklaratat e Përbashkëta, të cilat trajtojnë në mënyrë shumë të detajuar së çfarë është liberalizuar për çdo produkt, sipas shërbimeve apo japin shpjegime më të hollësishme teknike të nenëve të veçanta të Marrëveshjes.

## *MARRËVESHJA E NDËRMJETME (AD INTERIM)*

Procedurat e nevojshme për miratimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nga të dy palët, kërkojnë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje nga Parlamentet e 25 Vendeve Anëtare të BE-së dhe nga Parlamenti Shqiptar. Ky proces ratifikimi është i gjatë dhe kërkon një periudhë kohore 2-3 vjet.

Duke patur parasysh këtë *Komuniteti Europian dhe pala Shqiptare do të nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët "Interim Agreement"* (referuar nenit 135 të MSA-së), e cila do të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar dhe miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm Europian.

Marrëveshja e Ndërmjetme parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë midis dy vendeve, për një periudhë tranzitore *10 vjeçare*. Gjithashtu ajo parashikon *stadet e hapjes* së tregut vendas për eksportet e BE-së. Të dyja palët janë angazhuar për të hequr tarifat doganore për mallrat me origjinë nga vendet e palëve apo masa të tjera me efekt të njëjtë ose të reduktojnë gradualisht tarifat doganore deri në eliminimin plotë të tyre gjatë një periudhe tranzitore pesë vjeçare të parashikuar në marrëveshje. Me përjashtim kjo, vetëm për mallrat e përfshira në listën e produkteve sensitive, tarifat doganore të cilave nuk do të ndryshojnë dhe për këtë arsye ato janë lënë jashtë Marrëveshjes. Marrëveshja përmban 57 nene, 4 Anekse dhe 5 Protokolle, të lidhura me lëvizjen e lirë të mallrave, konkurrencën dhe provizione të tjera ekonomike, ndërmarrjet publike, pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare dhe definicionet mbi transportin.

## *Cila është procedura ligjore për hyrjen në fuqi?*

Marrëveshja e Ndërmjetme lidhet vetëm me masat tregtare dhe aspektet e lidhura me të. Për vetë specifikën e saj, procedurat për hyrjen e saj në fuqi, janë më të thjeshtuara se MSA-ja. Kjo marrëveshje nuk ratifikohet nga të 25 parlamentet e vendeve Anëtare të BE-së, por nga Këshilli i Përgjithshëm, me procedurë të përshpejtuar, si dhe ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar.

Në bazë të Nenit 57 të Marrëveshjes së ndërmjetme, palët do të ratifikojnë apo aprovojnë këtë marrëveshje në përputhje me procedurat e tyre. Marrëveshja do të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar dhe do të aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Europian (neni 55).

Marrëveshja do të hyjë në fuqi *ditën e parë të muajit të dytë pas datës së depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit apo aprovimit*.

## *ÇFARË PËRFAQËSON TREGTIA E LIRË PËR PRODUKTET SHQIPTARE NË TREGUN E VENDEVE TË BE- 25 DHE VENDET E TJERA TË RAJONIT?*

Marrëveshja e Ndërmjetme me BE-në është një marrëveshje komplementare me MTL Rajonale dhe mar-

(vijon në faqen 10)

## Informacion mbi përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Marrëveshjen e Ndërmjetme (ad interim)

(vijon nga faqja 9)

rëveshjen e Organizatës Botërore të Tregëtisë (OBT). Ajo përmban të gjitha masat e një marrëveshjeje të tregtisë së Lirë, si dhe MTL e nënshkruara me vendet e Rajonit, në bazë të nenit XVIII të OBT-së.

Në ndryshim nga MTL Rajonale, për pjesën e liberalizimit të tarifave, mund të thuhet se MTL me BE-në 25 është asimetrike, jo reciproke, pra në favor të Shqipërisë<sup>1</sup>. Kjo sepse, në këtë marrëveshje, Shqipëria ka liberalizuar rreth 80% të shkëmbimeve të saj tregtare me Bashkimin Europian, ndërsa shkalla e liberalizimit të ofruar nga Bashkimi Europian për mallrat shqiptare është rreth 90 %.

Gjithashtu, në këtë marrëveshje nuk është ndjekur logjika e liberalizimit me kuota tarifore, për produktet bujqësore, siç është bërë në MTL rajonale, për ta thjeshtuar kuptimin dhe zbatimin e MTL nga eksportuesit/importuesit dhe organet doganore.

Marrëveshja e Ndërmjetme në raport me OBT mund të shihet e të trajtohet në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në OBT. Gjithë kuadri tregtar dhe instrumentat e tij, të negociuara në Marrëveshjen e Ndërmjetme janë dhe i bëjnë referencë kuadrit tregtar të PBT.

### *Produktet Bujqësore*

Lidhur me produktet bujqësore, për vetë specifikën e këtij sektori, ka një kategorizim më të specifikuar të liberalizimit të tregtisë. Produktet bujqësore ndahen në produkte primare bujqësore dhe produkte të përpunuara bujqësore.

Ato janë grupuar në tre kategori:

- jo sensitive – tarifatat doganore të importit bëhen menjëherë 0%;

- mesatarisht sensitive – tarifatat doganore reduktohen në mënyrë të përshkallëzuar për një periudhë pesëvjeçare;

- shumë sensitive – tarifatat doganore nuk ndryshojnë. Në total, liberalizimi i sektorit bujqësor rezulton të jetë: 73.9% të linjave tarifore nga Kapitulli 1-24 të Nomenklaturës ose 79.2% të vlerës së importit të produkteve bujqësore.

### *Produktet bujqësore Primare*

#### *Liberalizimi i Eksporteve:*

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, të gjitha produktet primare bujqësore, me origjinë shqiptare, mund të eksportohen në 25 vendet e Bashkimit Europian

me tarifë doganore 0%. Në bazë të nenit 14 të marrëveshjes përjashtim bëjnë vetëm produktet:

- *Mishi i qingjit dhe gjedhit, me origjinë shqiptare:* Tarifatat doganore të tyre kur eksportohen në vendet e BE-së nuk ndryshojnë, liberalizimi i tarifave doganore nga ana e Komunitetit Europian, do të negociohet në një periudhë të mëvonshme. Kodet doganore të këtyre produkteve janë: 0102, 0201, 0202.

- *Perimet dhe frutat me origjinë shqiptare:* Tarifatat doganore të tyre kur eksportohen në vendet e BE-së do të bëhen 0%, por do të aplikohet një detyrim doganor specifik. Kodet janë: 0700 dhe 0800.

- *Sheqeri me origjinë shqiptare:* Do të eksportohen në vendet e BE-së, me kuota tarifore vjetore prej 1000 ton. Brenda kësaj kuote nuk aplikohet detyrim doganor. Kodet janë: 1701 dhe 1702.

#### *Liberalizimi i Importeve:*

Liberalizimi i produkteve primare bujqësore që importohen nga vendet e BE-së është përcaktuar në Aneksin II. Në këtë Aneks këto produkte janë grupuar në tre kategori, me shkallë të ndryshme liberalizimi, sipas tre anekseve:

*Aneksi II (a);*

*Aneksi II (b);*

*dhe Aneksi II (c), si më poshtë:*

1) Produkte bujqësore primare “jo sensitive” – tarifatat doganore mbi importet e produkteve me origjinë komunitare të listuara në këtë aneks bëhen 0% me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Aneksi II (a) Ky grup produktesh përbën rreth 40.08% të produkteve bujqësore.

Në këto produkte kryesisht bëjnë pjesë kafshë dhe shpendë për përmirësim rracor, fidana, kërpudha, lule dielli, duhani etj. Këto produkte kanë pasur tarifa doganore të ulta ose janë importuar në sasira të pakonsiderueshme. Është marrë parasysh kërkesa e biznesit për të futur produktet që përdoren për lëndë të parë nga Industrinë përpunuese dhe nuk prodhohen në vend.

2) Produkte bujqësore primare të konsideruara “mesatarisht sensitive” – tarifatat doganore mbi importet e produkteve me origjinë komunitare të listuara në Aneksin II (b) reduktohen gradualisht për një peri-

(Vijon në faqen 11)

## Informacion mbi përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Marrëveshjen e Ndërmjetme (ad interim)

(vijon nga faqja 10)

udhë 5 vjeçare sipas skemës së mëposhtëme. Ky grup produktesh përbën rreth 29.1% të produkteve bujqësore.

Në këtë kategori të produkteve hyjnë ato produkte bujqësore taksa doganore e të cilave ulet në mënyrë graduale për një periudhë 5 vjeçare:

90% në ditën e firmosjes

80% në 1 janar 2007

60% në 1 janar 2008

40% në 1 janar 2009

0% në 1 janar 2010

Produktet kryesore janë; qumësht pluhur, djathra për përpunim, materiale gjenetike, niseshte, komposto, etj.

3) Produkte bujqësore primare, për të cilat aplikohet kuota tarifore sipas Aneksit II (c).

Produktet me kuota tarifore:

*Në bazë të Aneksit II(c)*

Përfshihen vetëm produktet: grurë për të cilat kuota tarifore është 20.000 euro ton. Nëse tejkalohet kuota e 20.000 ton për të dyja këto produkte, së bashku, aplikohet tarifa doganore 2%. Parimi i shfrytëzimit të kuotës është "i pari që vjen, i pari që përfiton". Kodi doganor është: 1001.90.91 dhe 1001.90.99

*Shkalla e liberalizimit të produkteve Bujqësore Primare është 69.9% të linjave tarifore ose 68.3% të vlerës së importit.*

4) Ka edhe një kategori të veçantë të Produkteve bujqësore që janë konsideruar "shumë sensitive", të cilat nuk janë të përfshira në Aneset e mësipërme, për të cilat pala shqiptare nuk ka dhënë konçensione për to. Këto produkte do të ruajnë tarifën doganore aktuale në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes për një periudhë tranzitore, deri sa të dyja palët të vendosin për rishikimin e tyre. Mbrojtja e tyre është bërë për konsolidimin e industrisë vendase dhe për krijimin e më shumë investimeve në sektorin e prodhimeve bujqësore. Në këtë grup bëjnë pjesë më shumë se rreth 30% e produkteve primare bujqësore.

Klasifikimi i produkteve si më sipër ka ardhur si rrjedhojë e konsultimeve me të gjithë përfaqësuesit e prodhuesve si edhe ata të KASH. Në të janë marrë në konsideratë analizat dhe argumentat e paraqitura lidhur me gjendjen dhe drejtimet e zhvillimit të

brendshëm Agro ushqimor. Gjithashtu është marë parasysh dhe impakti i vogël në të ardhurat doganore. Ne mendojmë se hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje nuk do të ketë impakt negativ për prodhuesit Shqiptarë për arsye se në produktet jo sensitive me tarifë 0% janë kryesisht produkte që prodhuesit tanë nuk kanë qenë të interesuar për t'i prodhuar, janë ato produkte që shërbejnë si lëndë e parë dhe ndihmëse (malto për birrë, lule dielli, të gjitha llojet e farërave, vajrat e papërpunuara, duhanet, arra e hindit për industrinë e sallamit, etj) për Industrinë përpunuese. Kjo marrëveshje ruan gjithashtu një ekuilibër më harmonik midis interesave të prodhuesve dhe konsumatorit.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me biznesin dhe prodhuesit e mëdhenj, që kanë qenë të përfshirë në negociatat me BE-në. Kohët e fundit është ngritur një grup pune, në mënyrë që të shtohet gama e përfituesve në skemën e rimbursimit të TVSH-së për grumbulluesit dhe përpunuesit, që të nxiten të blejnë prodhimin vendas si lëndë e parë, gjë e cila çon në rritjen e prodhimeve tona bujqësore.

*Produktet e përpunuara bujqësore*

Produktet e Përpunuara Bujqësore janë të trajtuara në një protokoll të veçantë, protokollin 2, i cili përcakton tregtinë mes dy palëve për këto produkte. Protokollin përfshin katër anekse në zbatim të tij: Aneksi I dhe Aneksat II a), II b) dhe II c).

*Liberalizimi i Eksporteve*

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, të gjitha produktet e përpunuara bujqësore, me origjinë shqiptare, të listuara në Aneksin I mund të eksportohen në 25 vendet e bashkimit Europian me tarifë doganore 0%. Këtu përfshihen produkte shqiptare të tilla si kosi, gjalpi, perime të përgatitura, uji, makarona, etj.

Gjithë produktet e tjera të cilat nuk janë në këtë Aneks, do të eksportohen në tregjet e BE-së me tarifën e tyre doganore.

*Liberalizimi i Importeve*

Liberalizimi i produkteve të përpunuara bujqësore që importohen nga vendet e BE-së është përcaktuar në Aneksin II të protokollit 2. Në këtë Aneks, këto

(vijon në faqen 12)



## Informacion mbi përgatitjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Marrëveshjen e Ndërmjetme (ad interim)

(vijon nga faqja 11)

produkte janë grupuar në tre kategori, me shkallë të ndryshme liberalizimi, sipas *Aneksit II a); Aneksit II b) dhe Aneksit II c)*. Mënyrat e liberalizimit të tarifave doganore, sipas tre anekseve është e ngjashme me anekset e produkteve primare bujqësore.

*Produktet e Përpunuara Bujqësore Sensitive*

Produktet e përpunuara bujqësore, të mëposhtëme, janë konsideruar si sensitive për industrinë e agro përpunimit në Shqipëri.

*Industria e birrës; industria e bojës; industria e përpunimit të mishit; industria:*

Përqindja e liberalizimit për produktet e përpunuara bujqësore është afërsisht 93%.

*Vera dhe Pijet alkoolike*

Verërat janë gjithashtu një kategori e trajtuar me një protokoll të veçantë (*Protokolli 3*). Mbi tregtinë e Verërave dhe Pijeve alkoolike – i cili vendos rregullat e zbatueshme në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për verërat dhe pijet e tjera alkoolike. Protokollin përfshin:

- Një marrëveshje mbi koncesionet tregtare preferenciale reciproke për disa verëra (Aneksi I i Protokollit),
- Një marrëveshje mbi njohjen, mbrojtjen dhe kontrollimin e emërimit të verërave (Aneksi II i Protokollit). Aneksi përmban listat e indikatorëve gjeografikë për verën, listën e emrave të mbrojtura të verës për 25 vendet e Komunitetit dhe nga Shqipëria.
- Një marrëveshje mbi njohjen, mbrojtjen, kontrollin dhe emërimin e pijeve alkoolike dhe pijeve të aromantizuara (Aneksi III i Protokollit). Aneksi përmban listën e pijeve të mbrojtura për 25 vendet e Komunitetit dhe nga Shqipëria.

*Liberalizimi i Eksporteve:*

Në kuadër të këtij protokollin, Aneksi I, Shqipëria ka të drejtë të eksportojë rreth 7000 hl verë me origjinë shqiptare me kod doganor: ex 2204 10; ex 2204 29. Brenda kësaj kuote tarifore nuk do të aplikohet detyrimi doganor.

*Liberalizimi i Importeve:*

Në bazë të Aneksit I, Shqipëria mund të importojë rreth 10 000 hl verë me origjinë komunitare, me kod doganor: ex 2204 10 dhe ex 2204 21. Brenda kësaj kuote nuk do të aplikohet detyrimi doganor.

Ministria jonë nëpërmjet programit CARDS të BE-së do të realizojë ngrijen e kadastrës së verës, e cila do të jetë një bazë e fuqishme për të ardhmen e këtij sektori.

Në përfundim në mënyrë të përmbledhur, nisur nga situata aktuale dhe sfidat që e presin prodhimin bujqësor shqiptar në kuadrin e zbatimit të MSA-së mund të themi:

1. Po punohet intensivisht për rishikimin të planit kombëtar të përafritimit të legjislacionit (pjesa e bujqësisë) në përshtatjen e rregulloreve, direktivave dhe amendimet ligjore të nevojshëm në përputhje me ato të BE-së.
2. E gjitha kjo është përqendruar në disa fushata që BE i konsideron si prioritare të tilla si siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, shëndeti i kafshëve dhe bimëve.
3. Po punohet për hartimin e strategjive sektoriale dhe mbështetjeje për zbatimin e tyre për një rritje të qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe atij blegtoral me qëllim rritjen e konkurrencës në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm.
4. Në kuadrin e zbatimit të politikave të veçanta për sektorin prioritar në bujqësi po punojmë që brenda këtij viti të krijojmë një fond të veçantë për vreshtarinë dhe thertoret pasi me këto të fundit ka një gjendje e cila jo vetëm nuk përputhet me asnjë kusht që kërkohet në standardet e BE-së por kemi një situatë alarmante.
5. Po punojmë intensivisht për ngritjen e kapaciteteve kapaciteteve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së tregtimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe ushqimore, ngritjeve të tregjeve të shumicës, ruajtjes dhe tregtimit të këtyre produkteve.
6. Po punojmë intensivisht në bashkëpunim edhe me ministrinë e integritetit dhe institucionet e tjera në vend për informimin në vazhdimësi të biznesit bujqësor për impaktin që do të ketë zbatimi i MSA-së në fushën e bujqësisë dhe rrugët për përballimin e sfidave në këtë sektor.

## NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN MAJ 2006

*I- Projektligje të shqyrtuara në komisionet e përher-shme*

*të Kuvendit dhe në seancë plenare.*

*1. P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konflikteve të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar" (shqyrtuar në seancë plenare në datat 8 dhe 11 maj 2006).*

Projektligji synon të bëjë dy ndryshime në ligjin ekzistues:

- Të rivendosë detyrimin për deklarimin e burimit të pasurive të krijuara nga subjektet që deklarojnë pasurinë para fillimit të punës;

- Të rivendosë ndalimin për deputetët që të ushtrojnë veprimtari private si avokat, ekspert i licencuar dhe konsulent.

Deputetët u shprehën dakord me ndryshimin e parë, ndërsa për ndryshimin e dytë pati mendime të ndryshme.

Përfaqësuesit e Qeverisë argumentuan nevojën e ndryshimit të dytë, i cili ka për qëllim të përputhë ligjin "Për konfliktin e interesave" me Kushtetutën, që e barazon statusin juridik të deputetit me atë të anëtarit të Këshillit të Ministrave, si dhe me ligjin "Statusi i deputetit". Ky qëndrim u mbështet nga shumica e deputetëve.

Nga disa deputetë të opozitës u mbajt qëndrimi kundër ndryshimit të dytë, pasi sipas tyre deputeti në ekonominë e tregut ka të drejtë të kryejë veprimtari që lidhen me ushtrimin prej tij të profesionit dhe se ushtrimi i detyrave të avokatisë, ekspertit të licencuar ose të konsulentit nuk përbën ndonjë konflikt interesi me detyrën e deputetit.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash ta miratojë projektligjin pa ndryshime.

*2. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", paraqitur nga Këshilli i Ministrave (shqyrtuar në seancë plenare në datat 8 dhe 11 maj 2006).*

*3. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", paraqitur nga deputeti Nikollë Lesi (shqyrtuar në seancë plenare në datat 8 dhe 11 maj 2006).*

Të dy projektligjet e sipërcituara kanë të njëjtin objekt, atë të amendimit të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, prandaj shqyrtimi i tyre në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në seancë plenare u zhvillua bashkërisht.

Projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave ka për qëllim ristrukturimin e Këshillit Kombëtar të Radios e Televizionit dhe të Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe përcakton mënyrën e zgjedhjes, kriteret, papajtuesh-

mëritë dhe shpërblimin e anëtarëve të këtyre organeve.

Projektligji i paraqitur nga deputeti Nikollë Lesi synon rregullimin e marrëdhënieve midis mediave elektronike dhe kapitalit të kontrolluar nga subjektet publike dhe realizon ndarjen e interesave midis tyre. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik organizoi takime me aktorët e interesuar dhe të ndikuar nga ndryshimet e propozuara në këto projektligje.

Gjatë diskutimit në këtë Komision dhe në seancë plenare, shumica e deputetëve ishin të mendimit se, në kushtet kur në këto institucione ka patur mjaft raste të moszbatimit me korrektësi të ligjit, është i nevojshëm reformimi i tyre, mbi bazën e amendimeve në ligjin mbi të cilin ato funksionojnë. Duke marrë në konsideratë vërejtjet e subjekteve të interesuara dhe të përfaqësuesve të OSBE-së, Kuvendi, mbështetur në propozimet e komisionit përkatës, ndryshoi përmbajtjen e disa prej neneve të projektligjit, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me formulën e propozimit, të përzgjedhjes dhe të zgjedhjes së kandidatave për anëtarë të KKRT-së dhe të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Këto ndryshime synojnë formimin e këtyre institucioneve me anëtarë të zgjedhur jo mbi bazën e përkatësisë partiake, por nga subjekte të shoqërisë civile, të cilët kanë besueshmëri profesionale. Zgjedhja e anëtarëve të këtyre institucioneve propozohet të bëhet me mirëkuptim në Kuvend, duke përfshirë fazën përzgjedhëse në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Nga deputetët e shumicës kuvendore u vlerësua pozitivisht edhe projektligji i paraqitur nga deputeti Nikollë Lesi, i cili ndikon në rritjen e lirisë dhe të pavarësisë së medias.

Përfaqësuesit e opozitës i kundërshtuan projektligjet, me argumentet që ligji ekzistues ka nevojë për ndryshime në shumë dispozita të tij dhe jo vetëm në ato që kanë si objekt përbërjen e këshillave drejtues të KKRT-së dhe të RTSH-së, ndërprerja e mandateve të anëtarëve ekzistues në këto këshilla nuk është e përligjur, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj nuk garantojnë pavarësinë e këtyre institucioneve, ka defekte në përzgjedhjen e individëve nga shoqëria civile dhe çënohet pavarësia e këtyre institucioneve, duke rritur kompetencat ndërhyrëse dhe mbikëqyrjen e Kuvendit. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi i miratoi projektligjet dhe amendimet mbi to me shumicë votash dhe i pasqyroi ato në një ligj të vetëm.

*4. P/ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", të ndryshuar (shqyrtuar në seancë plenare në datat 18 dhe 29 maj 2006).*

Projektligji parashikon heqjen e tarifave doganore për nënproduktet e naftës, me qëllim respektimin e detyrimeve të vendit tonë në kuadër të marrëveshjeve

*(vijon në faqen 14)*

## NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN MAJ 2006

(vijon nga faqja 13)

të tregtisë së lirë, disiplinimin e tregut të hidrokarbureve, shmangien e praktikave abuzive dhe të konkurrencës së pandershme.

Efekti prej rreth 1.6 miliardë lekësh i heqjes së tarifave doganore parashikohet të kompensohet nëpërmjet rritjes së nivelit të akcizës për karburantet dhe lëndët djegëse.

Gjatë diskutimit për këtë projektligj në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe në seancë plenare, deputetët kërkuan të forcohet kontrolli për të ndaluar importin e nënprodukteve të naftës që nuk plotësojnë standardet europiane dhe që janë të dëmshme për mjedisin, si dhe të zbatohet ligji për hidrokarburet, i cili i ndalon subjektet që importojnë karburante për automjetet që të importojnë edhe lëndë djegëse për kaldajat, me qëllim që të mbyllën shtigjet a abuzimit me heating-oil, i cili shpesh tregtohet si gazoil.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua nga Kuvendi me votat e të gjitha grupeve parlamentare.

*5. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, (shqyrtuar në seancë plenare në datat 18 dhe 29 maj 2006).*

Projektligji parashikon këto ndryshime në ligjin ekzistues:

a) zgjerimin e skemës së përjashtimit nga akciza të karburanteve që përdoren në bujqësi, me qëllim stimulimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë;

b) rritjen e nivelit të akcizës për benzinën me plumb, benzinën pa plumb, gazoilin, lëndën djegëse, solarin e mazutin.

Rritja e akcizave të karburanteve, me efekt rritjen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit me 1,6 miliardë lekë në vit, bëhet për të unifikuar nivelin e akcizës për to me atë të vendeve të tjera në rajon e më gjerë, si dhe për të kufizuar praktikën abuzive dhe konkurrencën jo të ndershme në tregun e karburanteve.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe në seancë plenare, deputetët e mazhorancës u shprehën për miratimin e tij. Përfaqësuesit e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ai mund të sjellë rritje të çmimit të karburanteve.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave informuan deputetët se ndryshimet që propozohen në këtë projektligj nuk parashikohen të sjellin rritje çmimi në tregun e karburanteve, pasi efekti negativ i tyre kompensohet nga efekti pozitiv, si rezultat i heqjes së tarifës doganore për këta artikuj.

Nga disa deputetë u kërkuar që Qeveria të studiojë mundësinë e përfshirjes në skemën e përjashtimeve nga akciza edhe të sektorit të peshkimit.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

*6. P/ligji "Për administrimin mbetjeve të rrezikshme" (shqyrtuar në seancë plenare më datë 18 maj 2006).*

Projektligji mbështetet në direktivat e Këshillit të Europës dhe ka si qëllim të përcaktojë rregullat për administrimin e mbetjeve me rrezik të veçantë për shën-

detin dhe mjedisin, të vendosura në disa sheshe të lejuara nga autoritetet përkatëse shtetërore. Ai vendos disa detyrime për prodhuesit dhe administruesit e mbetjeve të rrezikshme, përcakton procedurat për dhënien e lejes për krijimin dhe funksionimin e shesheve të depozitimit të tyre, parashikon ndalimin e importit të çdo lloji mbetjeje dhe eksportin e tyre me autorizimin e organeve kompetente, si dhe masat ndëshkimore në rast shkeljeje të dispozitave të tij.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe në seancë plenare deputetët u shprehën pro miratimit të tij në parim. Nga deputetët u paraqitën disa amendamente për shtesa ose riformulime në disa nene të projektligjit, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Amendamenti për një shtesë në nenin 13, pika 1 të projektligjit, i cili propozon që në dokumentacionin që i dërgohet autoritetit shtetëror që ka në kompetencë dhënien e lejes mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme (sipas projektligjit është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ndërsa sipas komisionit përgjegjës është KRTRSH-ja) nga kërkuesi i saj, të përfshihet edhe miratimi nga këshilli i komunës së bashkisë për të. Një pjesë e deputetëve u shprehën dakord me këtë amendament, i cili i jep të drejtë organeve të pushtetit vendor që të japin mendimin për çështje të mjedisit që ato administrojnë, ndërsa disa të tjerë ishin kundër tij, me argumentin që sheshi i mbetjeve të rrezikshme i kapërcen interesat e një komune dhe është me rëndësi strategjike.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi ta miratojë amendamentin me një ndryshim, sipas të cilit dokumentacioni i kërkesës për leje mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme duhet të përmbajë edhe vendimin e këshillit të pushtetit lokal për miratimin ose jo të saj.

- Amendamenti që ndryshon organin kompetent për transferimin e lejes mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme tek një person tjetër nga Ministri, sipas projektligjit, tek KRTRSH-ja. Sipas amenduesit, duke qenë se kompetencën për dhënien e lejes së sheshit e ka KRTRSH-ja, edhe të drejtën për transferimin e lejes tek një person tjetër duhet të ketë i njëjti organ dhe jo ministri, që është organ më i ulët. Rreth këtij amendamenti pati mendime pro dhe kundër. Kundërshtimet u mbështetën në argumentin që KRTRSH-ja ushtron kompetencën vetëm për dhënien e lejes së sheshit nga pikëpamja urbanistike, ndërsa Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ushtron kompetencën për dhënien e lejes mjedisore në sheshin që autorizohet nga KRTRSH-ja.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash që të lerë në kompetencë të ministrit transferimin e lejes mjedisore tek një person tjetër.

(vijon në faqen 15)



## NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN MAJ 2006

(vijon nga faqja 14)

Projektligji u miratua në tërësi nga Kuvendi me shumicë votash.

*II- Raportime të institucioneve të pavarura*

*1. Raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (shqyrtuar në seancë plenare më datë 4 maj 2006).*

Gjatë diskutimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në seancë plenare rreth Raportit të paraqitur nga Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deputetët vunë në dukje disa defekte të punës së këtij institucioni gjatë vitit 2005, siç janë shkelja e afateve ligjore për kryerjen e fazave të ndryshme të procesit zgjedhor, mangësitë në listat e zgjedhësve, parregullsitë e ndodhura në disa zona gjatë numërimit të votave dhe mosshtrimi i plotë i kompetencave për zgjidhjen e ankesave para e paszgjedhore.

Në përfundim, Kuvendi miratoi një Rezolutë, në të cilën, krahas konstatimeve të përmendura më lart për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2005, kërkohet që gjatë vitit 2006 puna e tij të përqendrohet në: rritjen e përpjekjeve për zbatimin e legjislacionit zgjedhor gjatë zgjedhjeve vendore, veçanërisht për zgjidhjen e ankesave dhe numërimin e votave, rritjen e bashkëpunimit me organet e qeverisjes qendrore e vendore, rritjen e nivelit profesional të komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta, zbatimin e rekomandimeve të OSBE-ODHIR-it për përmirësimin e infrastrukturës zgjedhore, krijimin e kushteve të punës për funksionimin normal të komisioneve zgjedhore, etj.

*2. Raporti i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit (shqyrtuar në seancë plenare në datat 11 dhe 15 maj 2006).*

Në Raportin e paraqitur nga Kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së vlerësohet puna e institucionit për përmirësimin e strukturës së programeve dhe për administrimin e fondeve buxhetore, për të cilat pretendohet se janë të pamjaftueshme për funksionimin normal të institucionit dhe dobësojnë konkurrencën e tij me operatorët privatë. Nga Raporti evidentohet se RTSH-ja nuk e ka luajtur plotësisht rolin e tij si operator në shërbim të publikut, për shkak të ndikimit të politikës. Megjithë përpjekjet e institucionit për zbatimin e detyrimeve ligjore, ka patur edhe mangësi, të cilat shtrojnë nevojën e reformimit të strukturës drejtuese dhe të të gjithë institucionit.

Gjatë diskutimit rreth Raportit deputetët bënë vlerësimet si më poshtë:

- Përfaqësuesit e shumicës së deputetëve i vlerësuan të pabazuara pretendimet e paraqitura në Raport për mungesën e fondeve buxhetore. Ata theksuan se RTSH-ja nuk i ka zbatuar plotësisht rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përdorimin e fondeve buxhetore, pasi nuk ka arkëtuar borxhin që konkurrentët privatë i kanë këtij institucioni dhe ka patur disa shkelje ligjore në dhënien e pagave e shpërblyemeve. Ky institucion, sipas tyre, ende nuk ka realizuar detyrën për reformimin e strukturës së pagave dhe hartimin e piramidës së pagave të tij.

- Përfaqësuesit e opozitës shprehën mendimin se, pas zgjedhjeve të përgjithshme, është rritur kontrolli politik i Qeverisë ndaj RTSH-së, pasi nuk ka përpjesëtim të drejtë në kohën e zënë në televizion nga pozita dhe opozita, në disfavor të kësaj të fundit. Sipas tyre, veprimtaria e TVSH-së ka qenë e pamjaftueshme, jociësore dhe nuk i ka shërbyer si duhet publikut. Vështrësitë kryesore në punën e Këshillit Drejtues të RTSH-së, sipas tyre, kanë ardhur nga moszbatimi prej strukturave ekzekutive të udhëzimeve të dhëna prej tij, për shkak të boshllëqeve ligjore në drejtim të rolit kontrollues të Këshillit Drejtues ndaj Drejtorisë së RTSH-së. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash një Rezolutë, në të cilën kërkon shkarkimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe ngritjen e një Këshilli të ri, mbi bazën e përmirësimeve ligjore që do të bëhen së shpejti.

*3. Raporti i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për veprimtarinë e këtij institucioni për vitin 2005 (shqyrtuar në seancë plenare më datë 25 maj 2006).* Raporti u paraqit nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe në seancë plenare.

Gjatë diskutimit deputetët vlerësuan veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe ndikimin e saj në: ruajtjen e stabilitetit ekonomik e financiar të vendit, ruajtjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik e social, në përputhje me normat e parashikuara, mbajtjen e inflacionit brenda objektivit të parashikuar 2-4 për qind, forcimin e mëtejshëm të rezervës valutore, forcimin e kapacitetit mbikëqyrës dhe të kuadrit rregullator në fushën bankare, përmbushjen e objektivave të ndërmjetëm të programit monetar, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar, zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, zhvillimet pozitive në kreditimin e ekonomisë dhe forcimin e pavarësisë së institucionit.

Në përfundim, Kuvendi miratoi një Rezolutë për veprimtarinë e këtij institucioni për vitin 2005, në të cilën, krahas vlerësimeve pozitive, jepen edhe rekomandime për çështjet kryesore ku duhet të përqendrohet puna e këtij institucioni gjatë vitit 2006, siç janë forcimi i pavarësisë së institucionit, thellimi i rolit mbikëqyrës të tij në sistemin bankar, zbatimi i politikave monetare efektive e transparente dhe i standardeve bashkëkohore në fushën e licencimit dhe të mbikëqyrjes bankare, rritja e bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave për harmonizimin e politikës monetare me atë të zhvillimit ekonomik e financiar të vendit, harmonizimi i këtij bashkëpunimi me politikat fiskale, nxitja e kreditimit të ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar, përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së etj. Gjithashtu, në Rezolutë Kuvendi i kërkon Bankës së Shqipërisë të thellojë kontributin në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit dhe të luftës ndaj pastrimit të parave.

## NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN MAJ 2006

### *Veprimtaria legislative*

Gjatë muajit maj Komisioni i Integrimit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht këto projektligje kanë qenë ratifikime të disa marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa shteteve të tjera. Titujt e projektligjeve të shqyrtuara nga Komisioni i Integrimit vijojnë më poshtë:

1. *Propozim i projektligjit "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Për Garancitë Ndërkombëtare në Paisjet e Lëvizshme dhe në Protokollin e saj".*

Kjo Konventë dhe protokollin e saj për mjetet e fluturimit janë të hartuara për:

- Nevojat e përdorimit të paisjeve të lëvizshme, me vlerë të konsiderueshme, ku përfshihen mjetet fluturuese;

- Lehtësimin në financimin në këto vlera pasurore dhe futjen e "leasing-ut" në përdorimin e tyre në favor të zotërimit, të përdorimit dhe lehtësimit të procedurave juridike, që lidhen me këto veprime;

- Hartimin e një kuadri ligjor, të përshtatshëm dhe lehtësues, për veprimet financiare dhe ato të regjistrimit, të mbrojtjes dhe të garancive përkatëse. Komisioni i Integrimit duke pasur parasysh që standardet europiane janë të lidhura ngushtë me standardet ndërkombëtare, mendon se aderimi në këtë Konventë si dhe zbatimi i saj do të lejojë rritjen e nivelit të garancive në paisjet e lëvizshme.

Komisioni e miratoi projektligjin pa vërejtje me votë pro të të gjithë antarëve të pranishëm në mbledhje.

2. *Propozim i projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Sigurisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për Mbrojtjen e Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar".*

Kjo marrëveshje ka për objekt shkëmbimin e informacionit të një kategorie të veçantë të konsideruar si i klasifikuar. Nivelet e klasifikimit të sigurisë së informacionit të parashikuar në marrëveshje janë:

- Tepër sekret;
- Sekrete;
- Konfidencial.

Kjo marrëveshje do të krijojë precedent për finalizimin e marrëveshjeve të tjera ndërmjet institucioneve të tjera për transmetimin e informacionit të klasifikuar. Gjithashtu kjo marrëveshje do të krijojë garancitë ligjore për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer mes dy shteteve.

Duke e vlerësuar që kjo marrëveshje është në përputhje me rekomandimet e NATO-s, Komisioni e miratoi projektligjin pa vërejtje me votë pro të të gjithë antarëve të pranishëm në mbledhje.

3. *Propozim i projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për Mbrojtjen dhe Asistencën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit".*

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për Mbrojtjen dhe Asistencën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit", u nëshkrua në Tiranë, më datë 27 shkurt 2006, për palën shqiptare.

Marrëveshja dypalëshë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe zbatimi efektiv i saj do të mundësojë krijimin e një Autoriteti Përgjegjës i cili do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të interesave të fëmijëve në veçanti, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm.

Detyra kryesore e Autoritetit Përgjegjës do të jetë:

- bashkërendimi i procesit të referimit për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimi afatgjatë i viktimave;

- bashkërendimi i procedurave ndërmjet partnerëve zyrtarë dhe joqeveritarë shqiptarë, nga njëra anë, dhe strukturave përkatëse zyrtare joqeveritare në vendet e destinacionit nga ana tjetër.

Komisioni i Integrimit nxit Qeverinë që të ndërmerren iniciativa për:

- krijimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor kombëtar mbi fushat që mbulon kjo çështje;

- krijimin e strukturave përkatëse për monitorimin, parandalimin dhe ndalimin e këtij fenomeni;

- krijimin e një baze të të dhënave, shkëmbimeve statistike për trafikimin dhe format e shfrytëzimit të tij;

- ndërgjegjësimin e shoqërisë për këtë fenomen.

Komisioni e miratoi projektligjin pa vërejtje me votë pro të të gjithë antarëve të pranishëm në mbledhje.

4. *Propozim i projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të Programit Fillestar të Vlerësimit të Sfidës së Mijëvjeçarit".*

Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të "Programit Fillestar të Sfidës së Mijëvjeçarit", kanë rënë dakord që t'i japin Republikës së Shqipërisë shumën prej 13 850 000 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë ) USD.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është lufta kundër korrupsionit, forcimi i shtetit ligjor dhe përmirësimi i lirisë ekonomike në Shqipëri.

Kjo marrëveshje do të ketë në objektivat e saj:

- administratën tatimore;
- rritjen e transparencës;
- regjistrimet e biznesit;
- krijimin e një qendre kombëtare biznesi.

Lufta kundër korrupsionit është një ndër kërkesat prioritare të Bashkimit Europian, kusht për anëtarësimin e Shqipërisë. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë merr mirëfunksionimi i strukturave duke vepruar pa dallime në kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Granti do të lejojë përmirësimin edhe më tej të kësaj shtate dhe do të mundësojë afrimin e mëtejshëm të Shqipërisë në strukturat Euro- Atlantike.

Komisioni e miratoi projektligjin pa vërejtje me votë pro të të gjithë antarëve të pranishëm në mbledhje.

# KALENDAR I

## 3 Javor (12 qershor - 3 korrik 2006) i Punimeve të Kuvendit

### SEANCË PLENARE

E hënë, datë 12.06.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, dt. 8.06.2006.
3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të Punimeve të Kuvendit për periudhën 12 qershor – 3 korrik 2006.
4. P/ ligji “Për ratifikimin e Amendamentit të Dispozitive, që lidhen me tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë”.
5. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore”.
6. P/ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar.

### VEPRIMTARI NË KOMISIONE:

#### 13 Qershor– 28 Qershor 2006

1. P/ligji “Për ratifikimin e Konventës nr.143, “Për punëtorët migrantë, (Dispozitë plotësuese), 175” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bërë në Gjenevë”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni i Integritit**

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

2. P/ ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë, për mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni i Sigurisë Kombëtare**

3. P/ ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për transportin ndërkombëtar rrugor”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit**

4. P/ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimin (IDA), për projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor”.

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni i Integritit**

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

5. P/ligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8461, dt. 25.2.1999 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

· **Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik**

6. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit**

7. P/ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

8. P/ ligji “Për Autoritetin e Mbikqyrjes financiare”.

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

9. P/ligji “Për autoriparinimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisuara, dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit**

10. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar.

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

11. P/ ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e Punësimit”, të ndryshuar.

· **Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë**

12. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

· **Komisioni përgj: Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

· **Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

13. P/ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, “Për Programin Rajonal (CARDS 2005).

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni i Integritit**

· **Komisioni i Ekonomisë dhe Financave**

14. P/ ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së

(vijon në faqen 18)



## KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 17)

Industrive Gjermane (BDI/ (IFG), që veprojnë në emër të kreditorëve gjermanë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, kundrejt kreditorëve gjermanë, të pagarrantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni pËri Jashtëm**

· **Komisioni i Integritimit**

· **Komisioni i Ekonomisë dhe Financave**

15. P/ ligji “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncensionit, të Formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Pontilit të naftës, gazit e nën-produkteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto – Romanos, Durrës, ratifikuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit**

16. P/ ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ndërkombëtar rrugor”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

· **Komisioni i Jashtëm**

· **Komisioni i Integritimit**

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit**

17. Dekret nr. 4894, datë 6.06.2006 “Për kthimin e ligjit nr. 9531, datë 11.05.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”.

· **Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik**

· **Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

18. P/ ligji “Akti i Lirisë së Shtypit”.

· **Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik.**

19. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

20. P/ ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar (Paraqitur nga deputeti N.Lesi).

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

21. Shqyrtimi i propozimit për lirimin dhe emërimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacionit”.

· **Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit**

22. P/Vendim “Për zëvendësimin e Kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE)”.

· **Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit**

23. Shqyrtimi i kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e 4 anëtarëve të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

· **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

24. P/ligji “Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tratimit mbi të ardhurat nga punësimi, për personat juridik e fizik, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periodat tatimore të vitit 2005.

· **Komisioni i Ekonomisë dhe Financave**

### SEANCË PLENARE

**E enjte, datë 15.06.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare të datës 12.06.2006.

3. Interpelancë me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, kërkuar nga grupi parlamentar i PSD-së.

4. Interpelancë me Ministrin e Brendshëm, kërkuar nga deputetët Taulant Balla dhe Rrapush Tole.

5. P/ligji “Për ratifikimin e disa ndryshimeve në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë”.

6. P/ligji “Për ratifikimin e Konventës nr.143, “Për punëtorët migrantë, (Dispozitë plotësuese), 175” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bërë në Gjenevë”.

7. P/ ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

8. P/ ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Industrive Gjermane (BDI/ (IFG), që veprojnë në emër të kreditorëve gjermanë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, kundrejt kreditorëve gjermanë, të pagarrantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë”.

9. P/ ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar. (për votim).

10. Projektrezoluta “Për naftësjellësin “AMBO”.

### SEANCË PLENARE

**E hënë, datë 19.06.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

(vijon në faqen 19)

## KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(vijon nga faqja 18)

2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare dt. 15.06.2006.
3. P/Vendim "Për zëvendësimin e Kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE)".
4. P/ Vendim "Për lirim dhe emërim të një anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacionit (ERT).
5. Shqyrtimi i kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e 4 anëtarëve të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
6. Dekret nr.4894, datë 6.06.2006 "Për kthimin e Ligjit nr.9531, datë 11.05.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
7. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8701, datë 1.1.2.2000 "Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuara.
8. P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

### SEANCË PLENARE

**E enjte, datë 22.06.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare dt. 19.06.2006.
3. Interpelancë me Ministrin e Punëve Publike, Transportet dhe Telekomunikacionin, kërkuar nga deputetja Arta Dade.
4. P/ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, "Për Programin Rajonal (CARDS 2005).
5. P/ ligji "Për Autoritetin e Mbikqyrjes financiare".
6. P/ligji "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisuara, dhe për veprimtaritë që lidhen me to".
7. P/ligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar".

### SEANCË PLENARE

**E hënë, datë 26.06.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare dt. 22.06.2006.
3. P/ ligji "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncensionit, të firmës "BOT", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e Pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto – Romanos, Durrës, rati-fikuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004".
4. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ndërkombëtar rrugor".
5. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e Punësimit", të ndryshuar.

### SEANCË PLENARE

**E enjte, datë 29.06.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës së datës 26.06.2006.
3. Pyetje dhe Interpelanca.
4. P/ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".
5. P/ ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

### SEANCË PLENARE

**E hënë, datë 03.07.2006, ora 10.00**

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')
2. Miratimi i proces verbalit të Seancës Plenare dt. 29.06.2006.
3. Miratimi i kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 8 – 20 korrik 2006.
4. P/ ligji "për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995" Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
5. P/ligji "Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tratimit mbi të ardhurat nga punësimi, për personat juridik e fizik, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore të vitit 2005.

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit

Alma Kondakçiu  
Ditmir Bushati  
Denis Gila  
Filip Lako

Stafi i Projektit

Sokol Berberi  
Denada Breshanaj  
Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdp.org](http://www.ascdp.org)

Collaborators for the information on Government and Assembly activities

Alma Kondakçiu  
Ditmir Bushati  
Denis Gila  
Filip Lako

Project Staff

Sokol Berberi  
Denada Breshanaj  
Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdp.org](http://www.ascdp.org)